

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Gani Avdiu dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Biondina Zeneli, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve S.SH, V.SH dhe i mitur O.SH, të cilin e përfaqëson, përfaqësuesi ligjor i babai S.SH, të gjithë nga Komuna e Mitrovicës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Z.I, avokat në Prishtinë, ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S.", me seli ne Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M, përfaqësues juridik, me objekt kontesti kompensimin e dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën përfaqësuesit të autorizuar të paditurës Kompania e Sigurimeve "S.", të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2397/08, i datës 21.11.2018 në seancën jo publike, të mbajtur me datë 20.01.2023, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, Kompania e Sigurimeve "S." ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2397/08, i datës 21.11.2018, në pikën I të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material dhe jo material, dhe në pjesën në të cilën është refuzuar kërkesëpadia përtej shumës së aprovuar, pika II të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material dhe jo material, dhe në pjesën në të cilën është refuzuar kërkesëpadia përtej shumës së aprovuar dhe pika III e dispozitivit të aktgjykimit VËRTETOHET.

II.APROVOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, NDRYSHOHET Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2397/08, i datës 21.11.2018 në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit në pjesën që ka të bëjë me kamatë dhe tani gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S." që paditësve shumat e aprovuara si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë t'ua paguajë me kamatë ligjore në lartësi prej 8% duke filluar nga data 06.12.2017 (data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë) e deri në pagesën definitive.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2397/08, i datës 21.11.2018, në dispozitiv ka vendosur që: APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S., V. dhe O.SH, të gjithë nga Komuna e Mitrovicës, DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S.", me seli në Prishtinë, që paditësve, për shkak te lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.11.2008, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t'ua paguajë shumat si në vijim: 1.Për paditësin S.SH; Në emër të dëmit jo-material:- Për dhimbje fizike - trupore, shumën prej .  
.....1,200.00 euro, -Për frikën e përjetuar, shumën prej.....900.00 euro; 2. Për paditësen V.SH, Në emër të dëmit jo-material:- Për dhimbje fizike-trupore, shumën prej .  
..... 1200.00 euro, -Për frikën e përjetuar, shumën

prej.....900.00 euro; 3. Për paditësin e mitur O.SH, Në emër të dëmit jo-material:- Për dhimbje fizike-trupore, shumën prej .....1,000.00 euro, -Për frikën e përjetuar, shumën prej.....800.00 euro.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S.", me seli në Prishtinë, që paditësve S.SH, V.SH dhe O.SH, shumat e gjuvura si në piken -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme, prej 6,000.00 euro (gjashtëmijë), t'ia paguajë paditësve, me kamatë siç e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara të qytetarëve pa destinim të caktuar, mbi një vit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi 21.11.2018, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,044.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET si e pabazuar, pjesa e kërkesëpadsisë së paditësve S., V. dhe të miturit O.SH, përtej shumës së gjuvuar si në piken -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: Për paditësin parë, për dhimbje fizike shumën prej 300.00 euro, për frikë, shumën prej 400.00 euro dhe kujdes nga person i tretë shumën prej 30.00 euro, Për paditësen dytë, për dhimbje fizike, shumën prej 300.00 euro, për frikë shumën prej 400.00 euro dhe kujdes nga person i tretë shumën prej 30.00 euro, dhe Për paditësin tretë, kujdes nga personi i tretë, shumën prej 30.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ka paraqitur:

-përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Zbatimit të gaburt të së drejtës materiale, si dhe shpenzimet e procedurës me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar apo që aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre me datë 27.11.2008, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, të zgjeruar me parashtrësën e datës 15.04.2013 me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padsisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2397/08, i datës 21.11.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në këtë çështje juridike, nuk është kontestuese nga ndërgjyqësit, se paditësit kanë pësuar lëndime me rastin e aksidentit lëndor, mirëpo gjykata për të vërtetuar lartësinë e lëndimeve të paditësve në procedurën e provave ka administruar tërë dokumentacionin mjekësor lidhur me këtë çështje, nga i cili dokumentacion, konstatohet se paditësit kanë qenë të detyruar të marrin shërbime mjekësore, për shkak të lëndimeve të cilat i kanë pësuar me rastin e aksidentit në komunikacion te datës 11.11.2008, andaj këto lëndime dhe natyra e tyre sipas propozimit të autorizuarit të paditësve, gjykata ka caktuar marrjen e provës sipas ekspertizës mjekësore nga lëmia e ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë dhe ka caktuar ekspertët mjekësorë, Dr. S,S dhe Dr. S.B, me ç ‘rast pas shqyrtimit të tërë dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës për paditësit dhe të bazuar në dokumentacionin mjekësor, gjykata konstatoi se në aksidentin e trafikut të datës 18.11.2008, paditësit kanë pësuar lëndime të natyrës së lehtë trupore.

Me këto prova të administruara, gjykata, për paditësin e parë S.SH, në emër të dhimbjeve fizike, ka aprovuar kërkesëpadinë në shumën prej 1,200.00 euro, të cilën shumë e vlerëson si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit-mjekësor, paditësi nga momenti i shkaktimit të lëndimit e deri në ofrimin e trajtimit në Qendrën Emergjente të Spitalit Regjional të Pejës, është konstatuar se ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë për 1 ditë, dhe atë për shkak të lëndimeve të pësuar në formë të edemës, hematomave të brendshme, dhimbje të intensitetit të mesëm ka përjetuar edhe për 10 ditë të tjera për shkak të vazhdimit të tërheqjes së edemave dhe hematomave në regjionet e lënduara dhe si pasojë e fillimit të rekuperimit të strukturave anatomike të lënduara, kurse dhimbje të intensitetit të ulët është konstatuar se nuk ka pasur.

Në emër të frikës së pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.11.2008, për paditësin e parë S.SH, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumë prej 900.00 euro, të cilin e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertes mjekësore, rezulton se të paditësi frika primare nuk është konstatuar për shkak se aksidenti ka qenë i befasishëm dhe goditja ka ardhë nga mbrapa veturës, ndërsa ka ardhur në shprehje frika sekondare e intensitetit të lartë, e cila është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, çrregullim gjumi, çrregullim disponimi, ankesa te shumta somatike dhe simptoma tjera të reagimit akut ndaj stresit, që ka zgjatë për 24 orë. Po ashtu, është konstatuar frikë sekondare me intensitet mesatar dhe të ulet, e cila ka zgjatë nga 2 deri në 4 muaj, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, zgjime të herëpashershme gjatë gjumit, vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme si dhe rikujtime të shpeshta të ngjarjes traumatike, frikë dhe pasiguri të cilën paditësi e ndjen edhe sot e kësaj dite gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Për paditësen e dytë, V.SH, në emër të dhimbjeve fizike, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumën prej 1,200.00 euro, të cilën shumë e vlerëson si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit-mjekësor, paditësja, nga momenti i shkaktimit të lëndimit e deri ne ofrimin e trajtimit në Qendrën Emergjente te Spitalit Regjional te Pejës, është konstatuar se ka përjetuar• dhimbje të intensitetit të rëndë për I dite, dhe atë për shkak të lëndimeve të pësuar në formë të edemës, hematomave të brendshme, dhimbje të intensitetit të mesëm ka përjetuar edhe për 10 dite të tjera për shkak të vazhdimit të tërheqjes së edemave dhe hematomave ne

regjionet e lënduara dhe si pasojë e fillimit të rekuperimit të strukturave anatomike të lënduara, kurse dhimbje të intensitetit të ulët është konstatuar se nuk ka pasur. Në emër të frikës së pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.11.2008, për paditësen V.SH, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumë prej 900.00 euro, të cilin e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertës mjekësore, rezulton se të paditësja frika primare nuk është konstatuar për shkak se aksidenti ka qenë i befasishëm dhe goditja ka ardhë nga mbrapa veturës, ndërsa ka ardhur në shprehje frika sekondare e intensitetit të lartë, që ka zgjatur 24 orë dhe e cila është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes dhe simptome përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit. Po ashtu, është konstatuar frikë sekondare me intensitet mesatar dhe të ulët, e cila ka zgjatë nga 2 deri në 3 muaj, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit ansioz, zgjime të herëpashershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike, frikë dhe pasiguri të cilën paditësi e ndjen edhe sot e kësaj dite gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Për paditësin e tretë, të miturin O.SH, në emër të dhimbjeve fizike, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumën prej 1,000.00 euro, të cilën shumë e vlerëson si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit mjekësor, paditësi, nga momenti i shkakimit të lëndimit e deri në ofrimin e trajtimit në Qendrën Emergjente të Spitalit Regjional të Pejës, është konstatuar se ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë për 1 ditë, dhe atë për shkak të lëndimeve të pësuar në formë të edemës, hematomave të brendshme, dhimbje të intensitetit të mesëm ka përjetuar edhe për 7 dite të tjera për shkak të vazhdimit të tërheqjes së edemave dhe hematomave në regjionet e lënduara dhe si pasojë e fillimit të rekuperimit të strukturave anatomike të lënduara, kurse dhimbje të intensitetit të ulët është konstatuar se nuk ka pasur. Në emër të frikës së pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.11.2008, për paditësin O.SH, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumë prej 800.00 euro, të cilin e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertës mjekësore, rezulton se të paditësi frika primare nuk është konstatuar për shkak se aksidenti ka qenë i befasishëm dhe goditja ka ardhë nga mbrapa veturës, ndërsa ka ardhur në shprehje frika sekondare e intensitetit të lartë, e cila është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, jo rehati, problem me gjumin, ankesa të shumta somatike, që ka zgjatë për 1 ditë. Po ashtu, është konstatuar frikë sekondare me intensitet mesatar dhe të ulët, e cila ka zgjatë për 3 muaj, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit ansioz, zgjime të herëpashershme gjatë gjumit, ndjeshmëri emocionale etj.

Gjykata më rastin e vendosjes për paditësit në lidhje me lëndimet trupore të shkaktuara me rastin e aksidentit, për dhimbjet fizike të përjetuara në aksident dhe për frikën e pësuar nga aksidenti i komunikacionit në fjalë, ia ka falur besimin, ekspertizës së ekspertëve mjekësor, meqenëse e njëjta përmban dhëna dhe elemente të nevojshme mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje juridike kontestimore, për të cilën ekspertizë mjekësore nuk kanë paraqitur vërejtje apo kundërshtime as palët ndërgjyqëse.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura mban përgjegjësinë, e në bazë të fajit, të dëmit që i është shkaktuar paditësve me rastin e lëndimeve gjatë aksidentit të komunikacionit për çka e paditura është e

obliguar që paditësve të ua kompensojë dëmin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurën - Kompaninë e Sigurimeve "S.." dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bënë e paditura mbi bazën e sigurimit të auto-përgjegjësisë TPL (sigurimit të detyrueshëm për palët e treta), në pajtim me nenin 178 al. I dhe nenin 154 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur, që ti refuzojë në tërësi kërkesat e paditësve për kompensim të dëmit material përtej shumave të gjykuara si dhe për ndihmën e personit të tretë, ngase nga shkresat e lëndës gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se qëndrojnë pretendimet e paditësve në këtë drejtim, prandaj gjykata nuk ka mundur t'ua falë besimin pretendimeve të kësaj natyre të cilat nuk janë të argumentuara me prova konkrete dhe për këto arsye ka vendosur si dispozitiv të këtij aktgjykimi lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadsisë. Gjykata ka konsideruar se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfaksion moral dhe shpajim real për format e dëmeve pësuar të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimet dhe pasojat duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara në dispozitën e nenit 200 të LMD-së, si dhe standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikata e deritanishme të gjykatave të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë përveç kërkesës kryesore, paditësve ua ka njohur edhe të drejtën në kamatë në lartësi aq sa paguajnë bankat për mjetet e deponuara në bankat që afarojnë në Kosovë në afat më tepër se një vit, pa destinim të caktuar duke iu llogaritur nga data 09.11.2018, data kur është marr aktgjykimi e deri në pagesën definitive duke u bazuar në dispozitën e nenit 277 par. I të LMD-së.

Tutje në arsyetim të aktgjykimit të atakuar theksohet se në këtë çështje juridike, siç shihet edhe nga arsyet e lartcekura, kontestuese ka qenë vetëm afatshmëria (parashkrimi) e kërkesës së paditësve në raport me të paditurën. Sipas Gjykatës së shkallës së parë pretendimet e të paditurës në afatshmërinë e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e dëmit nga ana e paditësve, pasi që sipas të njëjtës nga dita e ndodhjes së aksidentit të komunikacionit, kanë kaluar rreth 5 vite, duke iu referuar nenit 362 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe sipas të paditurës në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për kompensim dëmi. Gjykata e shkallës së parë këto pretendime i ka vlerësuar si të paqëndrueshme, sepse fillimisht nga përfaqësuesi i paditësve, fillimisht ka qenë e paditur Kompaninë e Sigurimeve "S..", ndërsa pas vënies në dijeni, se automjeti është i siguruar ka qenë tek tani e paditura e cila është kuptuar nga përfaqësuesi i paditësve, vetëm pas përgjigjes në padi nga ish e paditura Kompania e Sigurimeve "S.." me datë 12.04.2013, me ç' rast është bërë precizimi i kërkesëpadsisë në aspektin subjektiv, duke e kërkuar kompensimin e shumave të cekura si në petitem të kërkesëpadsisë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..". Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se vëren se paditësit me autorizimin për përfaqësim të datës 17.11.2008, e kanë autorizuar përfaqësuesin e tyre, që i njëjti të ushtrojë padi dhe t'i ndër marrë të gjitha veprimet në gjykatë për dëmshpërblim kundër Kompanisë së Sigurimeve "S..". Gjykata vlerëson se kërkesa për kompensim dëmi në raport me ish-të paditurën Kompania e Sigurimeve "S..", në momentin e paraqitjes së padsisë ka qenë në tërësi brenda afatit të paraparë ligjor me dispozitat e nenit 362 të LMD-së, sepse nga momenti i pranimit të lëndës në gjykate, e deri në momentin e marrjes së aktvendimit për përgjigje në padi, kanë kaluar më shumë se 3 vite, përfaqësuesi i paditësve vlerësohet nga gjykata se ka bërë gabim teknik në parashtrimin-emërtimit të paditurës, sepse paditësit siç u theksua me lart me autorizim përfaqësuesin e tyre e kanë autorizuar që t'i

përfaqësoj ndaj tani të paditurës, mirëpo përfaqësuesi i paditësve nuk është vënë në dijeni të faktit se kërkesën për kompensim e ka drejtuar gabimisht ndaj një kompanie tjetër të sigurimit, e që do të duhet ta drejtonte ndaj tani të paditurës, nga kjo rezulton se paditësit kane qenë në dijeni nga momenti i dhënies së autorizimit përfaqësuesit të tyre se e paditur është kompania e sigurimeve "S.." që tani është e paditur, e jo siç ishte shkruar nga përfaqësuesi i tyre kompania e sigurimeve "S..", prandaj gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës siç pretendohet nga e paditura.

Gjykata e shkallës së parë tutje ka vlerësuar se paditësve në njëfarë mënyrë u është cenuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, e drejtë kjo që parashihet me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e vitit 1950, ku në nenin 6 të kësaj Konvente, parashihet që "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dite brenda një afati' arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij" Në këtë mënyrë gjykata konsideron, se sikur kjo çështje të ishte proceduar në një afat të arsyeshëm kohor rëga gjykata, nuk do të kishte ardhur fare deri të pretendimi i të paditurës, sa i për këtë parashkrimin të kërkesës. Për këtë arsye dhe arsyet e cekura me lart, u refuzua pretendimi i të paditurës sa i përket pretendimit për parashkrim të kërkesës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar konform dispozitave ligjore të neneve 449 dhe 452 par. I të LPK-së, si dhe tarifës së avokatëve, ku janë llogaritur shpenzimet procedurale dhe atë për parashtrimin e padisë shumë prej 104 euro, për taksin gjyqësore për padi shumë prej 60 euro, për ekspertizë shumë prej 340 euro, për pjesëmarrje në 2 shqyrtime gjyqësore (nga 270.40 euro për seancë), shumë prej 540.80 euro, duke arritur kështu në shumë të përgjithshme prej 1.044.00 euro (një mijë e dyzet e katër euro).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se i siguruari i të paditurës është shpallur përgjegjës në procedurën kundërvajtëse por po ashtu baza e kërkesëpadsisë nuk ka qenë kontestuese nga pala e paditur e që rrjedhimisht faktet e pohuara nga e paditura nuk kanë nevojë të provohen.

E paditura aktgjykimin e atakuar e ka goditur nga të gjitha bazat, por kryesisht fokusi i atakimit ka qenë te lartësia e kompensimit, parashkrimi dhe pastaj lartësia e shpenzimeve.

Në raport me prapësimin për parashkrim nga provat që gjinden në shkresat e lëndës pa mëdyshje mund të konkludohet se tani e paditura nuk ka qenë e përfshirë si palë e paditur në procedurës si rezultat i gabimit teknik, pasi nga vet provat ë dorëzuara me padi si raporti i policisë, polica e sigurimit dhe autorizimi për përfaqësim nga ana e avokatit, në të gjitha këto evidentohet tani e paditura Kompania e Sigurimeve “S..” dhe jo Kompania e Sigurimeve “S..”, por që është përvjedh si gabim teknik në emër, sepse është e pakuptimt të paditet një kompani tjetër që nuk figuron në raport të aksidentit dhe një kompani tjetër nga ajo që avokati ka marrë autorizimin, sepse sikur të paditej një kompani tjetër atëherë avokati nuk do të kishte të drejtë në përfaqësim pasi duhej autorizim tjetër.

Padia në gjykatë me këtë gabim teknik në emër është dorëzuar me datë 27.11.2008 rreth 16 ditë pas aksidentit, ndërsa veprimi i gjykatës për të vendosur kontakt me të paditurën sipas padisë ka qenë me datë: 21.02.2013 afër 5 vite pas dorëzimit të padisë. Me datë: 15.04.2013 avokati i paditësve pra rreth 2 muaj pas vënies së lëndës në punë apo në veprim ka bërë zgjerimin e padisë edhe ndaj tani të paditurës Kompania e Sigurimeve “S..”. I autorizuari i paditësve në seancën e datës 25.09.2013 ka bërë tërheqjen e padisë ndaj të paditurës KS “S..” sepse lënda nuk ka fare të bëjë me atë kompani dhe ka mbetur vetëm tani ndaj të paditurës.

Në rastin konkret edhe pse qartë vërtetohet se në padi si palë e paditur është paraqitur KS “S..” dhe jo KS “S..” , për shkak të mosveprimit të gjykatës si pasojë e ngarkesës me lëndë, vonesa në shqyrtim të lëndës në asnjë mënyrë nuk mund t’i atribuohet palës paditëse për gabimin teknik (duke llogaritur parashkrimin), pasi në rastin konkret edhe zgjerimi apo edhe ndryshimi i padisë duhet të vlerësohet dhe të trajtohet si korigjim i parashtrësës apo përmirësim në emër. Llogaritja e parashkrimit për shkak të veprimeve të cekura dhe të renditura si më lartë dhe vendimmarrja sikurse është kërkuar nga e paditura përbën cenim të sigurisë juridike, por edhe shkaktimin e pamundësisë së shqyrtimit të çështjes në gjykatë për palët paditëse.

Në raport me parashkrimin kjo gjykatë ndan mendimin e njëjtë me atë të gjykatës së shkallës së parë se nuk kemi të bëjmë me parashkrim, sepse parashkrimi në raport me të paditurën nuk duhet llogaritur sikurse pretendon tani e paditura pasi nuk ka afat për përmirësim të gabimit në emër nëse lënda nuk është trajtuar. Kjo mënyrë e vendimmarrjes dhe vlerësimit të çështjes edhe në aspektin e parashkrimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në përputhje me respektimin e të drejtave të njeriut.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjen mbështetje në nenin 154, 155, 158, 178, 185 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 26 Maj 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ *Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, me nenin 158 të këtij ligji përcaktohet se: “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”, ndërsa me nenin 178 përcaktohet se: “*Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë.*”.

Përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jo material për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar, Gjykata e Apelit vlerësoj se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar për secilin paditës

është në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jo material sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se paditësit kanë përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si në ekspertizë, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që kanë pësuar paditësit, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësve dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe në raport me kamatën, e po ashtu drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore edhe në raport me kompensimin e shpenzimeve procedurale, sepse e paditura i ka dhënë shkas padisë së paditësve.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) lidhur me pikën e) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.1017/2019, me datë 20.01.2023

Kryetari i kolegjit,  
Faton Ademi d.v